





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 569 Prot  
Nr. 1083/1 Dosje



Tiranë, më 24.02.2017

**VENDIM**

PËR PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë, Florian Shehu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit “**TDR GROUP**” sh.p.k., në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.10230/35 Akti, të lëshuar me Datë 13.01.2016 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.1083/1, Datë 04.02.2016 kërkesën e kreditorit Shoqëria “Shehu & Partners” sh.p.k, perfaqesuar nga administrator Znj. Ilva Spiro ndaj debitorit Shoqëria “Fada 1” shpk, në lidhje me titullin ekzekutiv “Faturë Tatimore Shitje Nr.08, date 14.07.2015”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr. 221 Prot, Datë 04.02.2016 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, kam kaluar në venie sekuestrosh konservative tek llogarite, kredite, asetet, pasuritë e luajtshme e te paluajtshme të tij.

Urdhërat për vendosjen e sekuestros konservative janë dërguar në:

1. 16 – Bankat Tregtare, me shkresën Nr.348 Prot. date 16.02.2016
2. Qendra Kombetare e Regjistrimit (QKR) – Nr. 347 Prot, date 16.02.2016

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

**KONSTATOJ**

Se prane Union Bank është sekuestruar vlera e plote e detyrimit referuar titullit ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje Nr.08, date 14.07.2015, e cila ju transferua kreditorit Shoqëria “Shehu & Partners” sh.p.k, perfaqesuar nga administratore Znj. Ilva Spiro.

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 32. Pikat (b,c) të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,



Shoqëria Përmbarimore Gjyqësore Private “TDR Group” sh.p.k  
Adresa : Bulevardi “Gjergj Fishta” Kulla Nr. 5 ,Kati i 11-të , Nr.54 Tiranë  
Tel : 00355 42 427790  
www.tdr.al




## VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.10230/35 Akti, të lëshuar me Datë 13.01.2016 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi detyrimi është shlyer plotësisht.
2. Urdhërohen Bankat Tregetare të Nivelit II, të zhbllokohen nga masa e sekuestros konservative depozitat, kredite apo llogarite bankare të Shoqëria "Fada 1" shpk me NIPT **K33708651V** bllokuar me shkresën Nr.348 Prot. date 16.02.2016, të Shoqërisë Permbartimore Private "TDR Group".
3. Urdhërohet QKR Tirane, të zhbllokojë nga masa e sekuestros konservative menjëherë aksionet e Shoqëria "Fada 1" shpk me NIPT **K33708651V**, bllokuar me shkresën Nr. 347 Prot, date 16.02.2016, të Shoqërisë Permbartimore Private "TDR Group".
4. Një kopje e vendimit të pushimit t'i dorëzohet paleve.

Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5-ditësh nga marrja e tij.

### SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k. PËRMBARUES GJYQËSOR

FLORIAN SHEHU



Shoqëria Përmbartimore Gjyqësore Private "TDR Group" sh.p.k  
Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr. 5 ,Kati i 11-të , Nr.54 Tiranë  
Tel : 00355 42 427790  
www.tdr.al